




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I.APROVOHET ankesa nr.8603 të datës 13.11.2023 dhe ankesa nr.8857 të datës 17.11.2023 parashtruar nga Shoqata e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus “Kosova e Lirë” me seli në Prizren dhe SHTU “Theranda” me seli në Suharekë, kundër vendimit nr.8423 të datës 03.11.2023 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht mosperfshirja e nisjeve ne relacionin:Prizren –Xërxë-Rahovec (07:15-08:35; 09:50-11:15; 14::20-15:35; 16:55-18:15) dhe nisjet ne relacionin:Suharekë – Prizren (09:10-10:10; 10:45-11:44; 11:15-12:10; 12:50-13:40; 14:30-15:20) si pjesë përbërse e nisjeve të shpallura si nisje të lira.

II. Obligohet Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës të bëjë shpalljen publike të nisjeve të lira sipas relacionuit: Prizren –Xërxë-Rahovec (07:15-08:35; 09:50-11:15; 14::20-15:35; 16:55-18:15) dhe nisjet ne relacionin:Suharekë – Prizren (09:10-10:10; 10:45-11:44; 11:15-12:10; 12:50-13:40; 14:30-15:20) në kuader të shpalljes publike të nisjeve të lira nderurbane në një porces tjetër administrativ.

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.8973 datë 22.11.2023 pas shqyrtimit të ankeave, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të

Faqe 1 nga 2

Objekti “Ish- Gërmia”, Rr . Nëna Terezë - 10.000 Prishtinë, Kosovë

<http://ëëë.mit-ks.net>

lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë faktin se nisjet e lartecekura jane pjese e rrjetit aktual dhe te nejtat jane te rendesishme per qytetaret e regjionit respektiv me qellim te krijimit te kushteve per levizje me te lehte te qytetareve te cilet shfrytezojne sherbimet e transporitit publik te udhetareve me autobus.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojnë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

